BASHKIA TIRANË
KËSHILLI BASHKIAK

V E N D I M

Nr. 3, datë 12.02.2015

PËR
"MIRATIMIN E NJË SHTESE NË BUXHETIN E KLUBIT SPORTIV "TIRANA" PËR DHËNIE STIMULI SPORTISTIT BEKIM BASHA PËR ARRITJE TË REZULTATEVE TË LARTA SPORTIVE"

Në mbështjetje të nenit 7 pika 2, nenit 10 pikat 1 dhe 3/II, nenit 32 shkronja "dh" të ligjit nr. 8652, datë 31.07.2000 për "Organizimin dhe Funksionimin e Qeverisjes Vendore" (i ndryshuar) dhe vendimit të Këshillit Bashkiak nr. 1, datë 26.02.2014 për "Miratimin e programit buxhetor afatmesëm 2014-2016 dhe detajimin e buxhetit të Bashkisë së Tiranës për vitin 2014" (i ndryshuar):

V E N D O S I:

1. Të miratojë një shtesë në buxhetin e Klubit Sportiv "Tirana" për dhënie stimuli sportistit Bekim Basha për arritje të rezultateve të larta sportive, shpalljen fitues i vendit të dytë (medalje argjendi) në Kampionatin Botëror të Karatesë për të rinj që u zhvillua në muajin Prill 2014, në strukturën dhe artikullin si më poshtë:

   Gr.00. Tit. 08140. Artikulli 606 200 000 lekë

2. Efektet financiare të pikës 1 të vendimit të përballohen duke pakësuar Fondin Rezervë të Bashkisë së Tiranës për vitin 2014, në të njëjtën shumë.

3. Për zbatimin e këtij vendimi ngarkohet Drejtoria e Planifikimit Strategjik dhe Klubi Sportiv "Tirana".

4. Ky vendim hyn në fuqi dhjetë ditë pas shpalljes.

K R Y E T A R I

ALDRIN DALIPI